

Nr. 08-BD/2026  
Prishtinë: 17.03.2026

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT, me numër fiskal 603383324, në mbështetje të: nenit 4, nenit 6 dhe nenit 17, paragrafi 5, nënparagrafet 5.13 dhe 5.14 të LIGJIT NR. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit; nenit 8 dhe nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.18, 1.20 dhe 1.21 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUdhËN E PËRKOHSHME, të miratuar më datë 31.12.2024, me numër protokollit 8648/24; në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 17.03.2026, nxjerr këtë:

### VENDIM

për miratimin e dokumenteve për ndarjen e çmimit "Inxhinieri i Vitit"

1. Miratohet **Udhëzuesi për ndarjen e çmimit "Inxhinieri i Vitit** të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, i cili përcakton kriteret, procedurat dhe mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për këtë çmim profesional.
2. Miratohet **Formulari i aplikimit për çmimin "Inxhinieri i Vitit**, i cili përdoret për paraqitjen e kandidatëve dhe dokumentimin e kontributit profesional të tyre në fushën e inxhinierisë dhe ndërtimit.
3. Miratohet **Matrica e vlerësimit për çmimin "Inxhinieri i Vitit**, e cila përcakton kriteret dhe sistemin e pikëzimit për vlerësimin objektiv dhe transparent të kandidatëve.
4. Dokumentet e miratuara sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi janë pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe përdoren në procedurat për nominimin, aplikimin dhe vlerësimin e kandidatëve për çmimin "Inxhinieri i Vitit".
5. Për zbatimin e këtij vendimi përgjegjëse është Administrata e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi Drejtues i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikëqyrës.
- Anëtarëve Themelues të Odës.
- Arkivit të OIRK-së.



Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**, Kryetar i OIRK-së \_\_\_\_\_
2. **Mimoza Shahini**, Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_
3. **Kadri Morina**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_
4. **Afrim Demiri**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_
5. **Nebi Pilana**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_



**ODA E INXHINIERËVE  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

6. **Bujar Jupaj**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_
7. **Sami Kolgeci**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_



**ODA E INXHINIERËVE  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

## **UDHËZUES**

### **PËR NDARJEN E ÇMIMIT “INXHINIERI I VITIT”**

**Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK)**

#### **Neni 1 - Qëllimi i çmimit**

Ky udhëzues përcakton kriteret, procedurat dhe mënyrën e përzgjedhjes së fituesit të çmimit “**Inxhinieri i Vitit**”, i cili ndahet nga Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK).

Qëllimi i këtij çmimi është:

- të njohë dhe të vlerësojë arritjet profesionale të inxhinierëve në Republikën e Kosovës;
- të promovojë cilësinë, integritetin dhe përgjegjësinë profesionale në ushtrimin e profesionit të inxhinierisë;
- të inkurajojë përdorimin e zgjidhjeve inovative dhe teknologjive moderne në projektim, ndërtim dhe menaxhim të projekteve;
- të rrisë prestigjin dhe reputacionin e profesionit të inxhinierisë në shoqëri;
- të promovojë respektimin e standardeve teknike dhe profesionale në projektim dhe realizim të projekteve inxhinierike;
- të motivojë dhe të inkurajojë zhvillimin profesional të vazhdueshëm të inxhinierëve;
- të promovojë shembuj pozitivë të profesionalizmit dhe etikës në profesionin e inxhinierisë;
- të kontribuojë në forcimin e rolit të inxhinierëve në zhvillimin ekonomik, infrastrukturor dhe teknologjik të Republikës së Kosovës.

Çmimi “**Inxhinieri i Vitit**” synon të bëhet një nga vlerësimet më të rëndësishme profesionale për inxhinierët në Republikën e Kosovës dhe të shërbejë si një instrument për promovimin e standardeve të larta profesionale dhe të kulturës së përgjegjesisë në inxhinieri.

#### **Neni 2 - Baza ligjore**

Ky udhëzues hartohet dhe zbatohet në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullative që rregullon veprimtarinë e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK).

Ky udhëzues mbështetet në:

- **Ligjin Nr. 08/L-012** për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, i cili përcakton organizimin dhe funksionimin e odave profesionale në fushën e ndërtimit;
- **Statutin** e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, i cili rregullon organizimin e brendshëm, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Odës;
- kompetencat e Bordit Drejtues të OIRK për promovimin, zhvillimin dhe avancimin e profesionit të inxhinierisë, si dhe për ndarjen e çmimeve dhe mirënjohjeve profesionale për anëtarët e Odës.

Në përputhje me këto akte, Bordi Drejtues i OIRK është organi kompetent për organizimin dhe zhvillimin e procesit të përzgjedhjes së fituesit të çmimit “Inxhinieri i Vitit”.

Bordi Drejtues, në kuadër të kompetencave të tij:

- miraton këtë udhëzues dhe çdo ndryshim ose plotësim të tij;
- shpall thirrjen për aplikim për çmimin “Inxhinieri i Vitit”;
- mbikëqyr procesin e aplikimit dhe vlerësimin të kandidatëve;
- siguron që procesi i përzgjedhjes të zhvillohet në mënyrë transparente dhe të bazuar në kritere profesionale;
- merr vendimin përfundimtar për ndarjen e çmimit.

Ky udhëzues përbën akt të brendshëm rregullues të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, i cili përcakton parimet dhe procedurat për ndarjen e çmimit “Inxhinieri i Vitit”.

### **Neni 3 - Fushëveprimi i çmimit**

Çmimi “**Inxhinieri i Vitit**” ndahet për anëtarët e licencuar të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK) që kanë dhënë kontribut të veçantë profesional gjatë vitit kalendarik në ushtrimin e profesionit të inxhinierisë.

Ky kontribut mund të lidhet me:

- realizimin e një projekti inxhinierik me rëndësi të veçantë;
- zhvillimin e zgjidhjeve inovative teknike ose teknologjike;
- përfshirjen në studime, analiza ose projekte të rëndësishme profesionale;
- kontributin në zhvillimin dhe përmirësimin e praktikave profesionale në fushën e inxhinierisë;
- ndikimin e rëndësishëm në zhvillimin e infrastrukturës, teknologjisë ose mjedisit.

Kandidatët për këtë çmim mund të vijnë nga fusha të ndryshme të inxhinierisë që përfaqësohen në OIRK, përfshirë:

- Inxhinieri ndërtimore (konstruktive, infrastrukture, hidroteknike);
- Inxhinieri gjeodezike;
- Inxhinieri gjeologjike dhe gjeoteknike;
- Inxhinieri e mjedisit;

- Inxhinieri elektrike;
- Inxhinieri mekanike.

Çmimi “**Inxhinieri i Vitit**” ndahet për një kandidat në vit, i cili vlerësohet se ka dhënë kontributin më të spikatur profesional gjatë periudhës përkatëse.

Në raste të veçanta, kur Bordi Drejtues vlerëson se ka edhe kontribute të tjera të rëndësishme profesionale, mund të ndahen edhe mirënjohje të veçanta profesionale për individë që kanë kontribuar në mënyrë të rëndësishme në zhvillimin dhe avancimin e profesionit të inxhinierisë.

## **Neni 4 - Kandidatët dhe kushtet për aplikim**

Për çmimin “**Inxhinieri i Vitit**” mund të kandidojnë inxhinierë që janë anëtarë aktivë dhe të licencuar të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK) dhe që gjatë vitit kalendarik përkatës kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm profesional në fushën e inxhinierisë.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- të jenë anëtarë aktivë dhe të licencuar të OIRK, me status të rregullt profesional në momentin e aplikimit;
- të kenë realizuar gjatë vitit përkatës një projekt, studim, inovacion teknik, publikim profesional ose aktivitet tjetër profesional me rëndësi të veçantë në fushën e inxhinierisë;
- të kenë ushtruar profesionin në përputhje me standardet teknike, rregulloret profesionale dhe parimet etike të profesionit të inxhinierisë;
- të kenë kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e projektit ose aktivitetit profesional që paraqitet për vlerësim;
- të mos jenë subjekt i procedurave disiplinore ose sanksioneve profesionale nga OIRK në momentin e aplikimit;
- të dorëzojnë dokumentacion të plotë dhe të verifikueshëm sipas kërkesave të përcaktuara në këtë udhëzues.

Kandidatët duhet të paraqesin informacion të saktë dhe të plotë lidhur me projektin ose aktivitetin profesional për të cilin aplikojnë, duke përfshirë përshkrimin e rolit të tyre profesional dhe kontributin konkret në realizimin e tij.

Në rastet kur projekti është realizuar nga një ekip profesional, kandidati duhet të specifikojë qartë rolin dhe përgjegjësinë individuale në projekt.

### **Mënyrat e nominimit të kandidatëve**

Kandidatët për çmimin “**Inxhinieri i Vitit**” mund të:

- aplikojnë në mënyrë individuale përmes formularit zyrtar të aplikimit;
- të propozohen nga kompani ose organizata ku ushtrojnë veprimtarinë profesionale;

- të propozohen nga institucione publike ose private që kanë bashkëpunuar me kandidatin në projekte profesionale;
- të propozohen nga universitete, institute kërkimore ose organizata profesionale në fushën e inxhinierisë;
- të propozohen nga anëtarë të tjerë të OIRK që vlerësojnë kontributin profesional të kandidatit.

Në rastet kur kandidati propozohet nga një institucion, organizatë ose individ tjetër, propozimi duhet të shoqërohet me arsyetim dhe dokumentacion mbështetës që dëshmon kontributin profesional të kandidatit.

### **Verifikimi i kandidaturave**

Administrata e OIRK është përgjegjëse për:

- pranimin dhe regjistrimin e aplikimeve;
- verifikimin e statusit të anëtarësisë dhe licencës së kandidatit;
- kontrollin e plotësisë së dokumentacionit të dorëzuar.

Vetëm aplikimet që plotësojnë kërkesat e këtij udhëzuesi do të konsiderohen të vlefshme për procesin e vlerësimit.

## **Neni 5 - Dokumentacioni i aplikimit**

Aplikimi për çmimin “**Inxhinieri i Vitit**” duhet të përmbajë dokumentacion të mjaftueshëm dhe të verifikueshëm që mundëson vlerësimin objektiv të kontributit profesional të kandidatit.

Dokumentacioni duhet të jetë i qartë, i plotë dhe të përshkruajë në mënyrë të detajuar rolin profesional, përgjegjësinë teknike dhe kontributin individual të kandidatit në projekt ose aktivitetin profesional të paraqitur për vlerësim.

Dokumentacioni i aplikimit duhet të përfshijë:

- formularin zyrtar të aplikimit, të plotësuar sipas kërkesave të përcaktuara nga OIRK;
- përshkrimin teknik të projektit ose kontributit profesional, ku paraqiten karakteristikat kryesore teknike, qëllimi i projektit dhe rëndësia e tij;
- informacion mbi rolin profesional të kandidatit në projekt, duke përfshirë përgjegjësitë teknike dhe kontributin individual;
- dokumente që dëshmojnë autorësinë dhe përgjegjësinë profesionale në projekt;
- dokumentacion teknik ose fotografik të projektit, që ilustron realizimin dhe karakteristikat kryesore të tij;
- CV profesionale të kandidatit, ku paraqiten përvoja profesionale, projektet kryesore dhe kualifikimet relevante;
- dokumente që tregojnë përdorimin e standardeve teknike dhe profesionale, si p.sh. Eurocode, EN, ISO ose standarde të tjera relevante për projektin.

Dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë i mjaftueshëm për të mundësuar vlerësimin e cilësisë profesionale, kompleksitetit teknik dhe ndikimit të projektit ose aktivitetit profesional.

### **Dëshmia e rolit profesional**

Për të siguruar transparencë dhe objektivitet në procesin e vlerësimit, kandidati duhet të paraqesë dokumente që dëshmojnë qartë rolin dhe përgjegjësinë profesionale në projektin ose aktivitetin profesional të paraqitur.

Dëshmitë duhet të konfirmojnë përfshirjen reale të kandidatit në projekt dhe mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- Lejen e ndërtimit, ku kandidati figuron si projektues, bashkëprojektues ose inxhinier përgjegjës;
- Kontratë për projektim, mbikëqyrje ose shërbime inxhinierike, ku kandidati është i përfshirë në mënyrë profesionale;
- Raport teknik, elaborat ose dokument projektimi ku figuron emri dhe përgjegjësia profesionale e kandidatit;
- Vendim emërimi si inxhinier përgjegjës, mbikëqyrës ose menaxher teknik në projekt;
- Vërtetim zyrtar nga kompania, institucioni ose investitori, që konfirmon rolin profesional të kandidatit në projekt;
- dokumente të tjera zyrtare që dëshmojnë përfshirjen dhe përgjegjësinë profesionale të kandidatit.

Në rast se projekti është realizuar nga një ekip profesional, kandidati duhet të përshkruajë qartë:

- rolin e tij në projekt;
- përgjegjësitë profesionale që ka pasur;
- kontributin individual në zgjidhjet teknike të projektit.

### **Verifikimi i dokumentacionit**

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK) rezervon të drejtën të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë për verifikimin e të dhënave të paraqitura në aplikim.

Në rast se konstatohet se dokumentacioni është i paplotë, i pasaktë ose nuk dëshmon qartë rolin profesional të kandidatit, aplikimi mund të refuzohet ose të mos merret në konsideratë në procesin e vlerësimit.

Administrata e OIRK është përgjegjëse për verifikimin administrativ të dokumentacionit të aplikimit para dorëzimit të tij për vlerësim nga Bordi Drejtues.

## **Neni 6 - Kriteret e vlerësimit**

Vlerësimi i kandidatëve për çmimin “**Inxhinieri i Vitit**” bëhet duke marrë parasysh disa elemente themelore që reflektojnë cilësinë, rëndësinë dhe ndikimin e kontributit profesional të kandidatit në fushën e inxhinierisë.

Gjatë procesit të vlerësimit, Bordi Drejtues analizon informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe merr në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

### **1. Inovacioni teknik dhe teknologjik**

Në këtë kriter vlerësohet niveli i inovacionit, kreativitetit dhe avancimit teknik në zgjidhjet e përdorura nga kandidati gjatë projektimit ose realizimit të projektit.

Vlerësimi merr parasysh jo vetëm përdorimin e teknologjive moderne, por edhe zgjidhjet kreative dhe të avancuara inxhinierike që kontribuojnë në zhvillimin e praktikës profesionale.

Në këtë aspekt mund të merren parasysh:

- përdorimi i metodave të reja ose të avancuara të projektimit dhe ndërtimit;
- aplikimi i teknologjive moderne në realizimin e projektit;
- zhvillimi i zgjidhjeve teknike që përmirësojnë efikasitetin, sigurinë ose performancën e strukturës;
- realizimi i zgjidhjeve strukturore kreative, si p.sh. konzolla të mëdha, hapësira të mëdha pa mbështetje ndërmjetëse, struktura me forma të veçanta ose sisteme të avancuara mbajtëse;
- zgjidhja e sfidave të veçanta teknike që kërkojnë qasje inovative në projektim;
- kontributi në avancimin e praktikave profesionale në fushën përkatëse të inxhinierisë.

Inovacioni teknik dhe kreativiteti inxhinierik konsiderohen elemente të rëndësishme që kontribuojnë në zhvillimin e profesionit dhe përmirësimin e standardeve të inxhinierisë.

### **2. Kompleksiteti teknik i projektit**

Vlerësohet niveli i kompleksitetit teknik të projektit ose aktivitetit profesional dhe sfidat që janë përballuar gjatë realizimit të tij.

Në këtë aspekt mund të merren parasysh:

- dimensionet dhe karakteristikat teknike të projektit;
- shkalla e vështirësisë së zgjidhjeve inxhinierike të përdorura;
- sfidat teknike, gjeoteknike, strukturore ose teknologjike që janë zgjidhur;
- koordinimi i disiplinave të ndryshme të inxhinierisë në projekt.

Projektet që kërkojnë nivel të lartë ekspertize dhe zgjidhje të avancuara teknike konsiderohen me rëndësi të veçantë në procesin e vlerësimit.

### **3. Ndikimi në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror**

Vlerësohet ndikimi i projektit ose aktivitetit profesional në zhvillimin ekonomik, social ose infrastrukturor.

Në këtë aspekt mund të merren parasysh:

- kontributi i projektit në përmirësimin e infrastrukturës publike;
- ndikimi në zhvillimin ekonomik të zonës ose sektorit përkatës;
- përfitimet që projekti sjell për komunitetin dhe shoqërinë;
- rëndësia strategjike e projektit në nivel lokal ose kombëtar.

Projektet që kanë ndikim të dukshëm në zhvillimin e vendit ose në përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve konsiderohen me vlerë të veçantë.

### **4. Qëndrueshmëria dhe mbrojtja e mjedisit**

Në procesin e vlerësimit merret parasysh edhe niveli i integritit të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në projekt.

Në këtë aspekt mund të vlerësohen:

- përdorimi i materialeve të qëndrueshme dhe teknologjive ekologjike;
- reduktimi i ndikimit negativ në mjedis gjatë ndërtimit ose funksionimit të projektit;
- efikasiteti energjetik i zgjidhjeve të përdorura;
- menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore.

Projektet që kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe në zhvillimin e qëndrueshëm konsiderohen me rëndësi të veçantë në vlerësim.

### **5. Cilësia profesionale dhe respektimi i standardeve**

Vlerësohet niveli i cilësisë profesionale në projektim dhe realizim të projektit.

Në këtë aspekt mund të merren parasysh:

- respektimi i standardeve teknike dhe profesionale ndërkombëtare (Eurocode, EN, ISO dhe standarde të tjera relevante);
- saktësia dhe cilësia e dokumentacionit teknik;
- siguria dhe qëndrueshmëria e zgjidhjeve inxhinierike;
- përputhshmëria e projektit me rregulloret dhe normat profesionale.

Cilësia profesionale është një element themelor që reflekton nivelin e përgjegjësisë dhe profesionalizmit të inxhinierit.

## 6. Kontributi individual i inxhinierit

Në procesin e vlerësimit merret parasysh roli konkret dhe përgjegjësia profesionale e kandidatit në projekt ose aktivitet profesional.

Në këtë aspekt mund të vlerësohen:

- roli i kandidatit në projekt (projektues, mbikëqyrës, menaxher teknik, ekspert i fushës etj.);
- shkalla e përgjegjësisë profesionale në vendimmarrje teknike;
- kontributi personal në zhvillimin dhe realizimin e zgjidhjeve inxhinierike;
- ndikimi i drejtpërdrejtë i kandidatit në suksesin e projektit.

Në rastet kur projekti është realizuar nga një ekip profesional, duhet të jetë e qartë pjesëmarrja dhe kontributi individual i kandidatit.

## Neni 7 - Procedura e aplikimit

Procesi i aplikimit dhe përzgjedhjes për çmimin “**Inxhinieri i Vitit**” zhvillohet në mënyrë transparente dhe të strukturuar, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë udhëzues.

Procesi përfshin këto hapa:

### 1. Shpallja e thirrjes për aplikim

Bordi Drejtues i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës shpall thirrjen për aplikim për çmimin “**Inxhinieri i Vitit**”.

Thirrja për aplikim publikohet në:

- faqen zyrtare të OIRK;
- kanalet zyrtare të komunikimit të Odës;
- dhe u dërgohet përmes postës elektronike (email) të gjithë anëtarëve të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës.

Thirrja për aplikim përmban informacion mbi:

- kriteret për aplikim;
- dokumentacionin e kërkuar;
- afatin për dorëzimin e aplikimeve;
- mënyrën e dorëzimit të aplikimeve.

## **2. Dorëzimi i aplikimeve**

Kandidatët dorëzojnë aplikimet e tyre brenda afatit të përcaktuar në thirrjen për aplikim.

Aplikimet dorëzohen në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga OIRK dhe duhet të përmbajnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas këtij udhëzuesi.

Aplikimet e dorëzuara pas afatit të përcaktuar nuk do të merren në konsideratë në procesin e vlerësimit.

## **3. Verifikimi administrativ i aplikimeve**

Administrata e OIRK është përgjegjëse për:

- pranimin dhe regjistrimin e aplikimeve;
- verifikimin e statusit të anëtarësisë dhe licencës së kandidatëve;
- kontrollin e plotësisë dhe rregullsisë së dokumentacionit të dorëzuar.

Në rast se dokumentacioni është i paplotë, administrata e OIRK mund të kërkojë nga kandidati plotësimin e dokumentacionit brenda një afati të përcaktuar.

Vetëm aplikimet që plotësojnë kërkesat e këtij udhëzuesi konsiderohen të vlefshme dhe i nënshtrohen procesit të vlerësimit.

## **4. Paraqitja e aplikimeve për vlerësim**

Pas përfundimit të verifikimit administrativ, administrata e OIRK përgatit listën e kandidatëve dhe ia paraqet aplikimet e kompletuara Bordit Drejtues për procesin e vlerësimit.

Bordi Drejtues shqyrton aplikimet në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë udhëzues dhe zhvillon procesin e vlerësimit për përzgjedhjen e fituesit.

## **5. Procesi i vlerësimit**

Anëtarët e Bordit Drejtues analizojnë dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe vlerësojnë kontributin profesional të secilit kandidat në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzues.

## **Neni 8- Vlerësimi i kandidatëve**

Vlerësimi i kandidatëve për çmimin “**Inxhinieri i Vitit**” bëhet nga **Bordi Drejtues i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK)**, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë udhëzues.

Procesi i vlerësimit zhvillohet në mënyrë profesionale, objektive dhe të paanshme, duke respektuar parimet e transparencës, integritetit dhe barazisë së trajtimit për të gjithë kandidatët.

Çdo anëtar i Bordit Drejtues shqyrton aplikimet dhe vlerëson kandidatët në mënyrë të pavarur, duke marrë parasysh në veçanti:

- rëndësinë profesionale të projektit ose aktivitetit të paraqitur;
- nivelin e inovacionit teknik dhe kompleksitetin e zgjidhjeve inxhinierike;
- ndikimin e projektit në zhvillimin e infrastrukturës, ekonomisë ose shoqërisë;
- respektimin e standardeve teknike dhe profesionale;
- kontributin individual të kandidatit në realizimin e projektit ose aktivitetit profesional.

Në procesin e vlerësimit, anëtarët e Bordit Drejtues analizojnë dokumentacionin teknik dhe profesional të paraqitur nga kandidatët dhe vlerësojnë cilësinë dhe rëndësinë e kontributit të tyre në fushën e inxhinierisë.

Pas përfundimit të vlerësimit individual nga secili anëtar i Bordit, rezultatet e vlerësimit mblidhen dhe përpunohen nga administrata e OIRK, duke përpiluar renditjen përfundimtare të kandidatëve sipas rezultatit të përgjithshëm të vlerësimit.

Në rast se gjatë procesit të vlerësimit konstatohet nevoja për sqarime shtesë lidhur me dokumentacionin e paraqitur, Bordi Drejtues mund të kërkojë informacione ose dokumente shtesë nga kandidati përkatës.

## **Neni 9 - Vendimmarrja**

Fituesi i çmimit “**Inxhinieri i Vitit**” shpallet me vendim të **Bordit Drejtues të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK)**, pas përfundimit të procesit të vlerësimit të kandidatëve.

Vendimi merret në bazë të rezultateve të vlerësimit të kandidatëve dhe të analizës së dokumentacionit të paraqitur nga secili kandidat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë udhëzues.

Bordi Drejtues shqyrton rezultatet e procesit të vlerësimit dhe renditjen përfundimtare të kandidatëve, duke marrë në konsideratë cilësinë dhe rëndësinë e kontributit profesional të secilit kandidat.

Vendimi për fituesin merret në mbledhjen e Bordit Drejtues dhe regjistrohet në procesverbalin përkatës.

### **Rasti i pikëve të barabarta**

Në rast se dy ose më shumë kandidatë kanë rezultat të njëjtë në procesin e vlerësimit, Bordi Drejtues mund të marrë parasysh faktorë shtesë për të përcaktuar fituesin, si:

- ndikimi publik dhe rëndësia e projektit për zhvillimin e shoqërisë;
- niveli i inovacionit teknik dhe teknologjik;
- kompleksiteti i zgjidhjeve inxhinierike të realizuara në projekt;
- kontributi individual i kandidatit në projekt ose aktivitet profesional.

Në raste të veçanta, kur Bordi Drejtues vlerëson se disa kandidatë kanë dhënë kontribute të jashtëzakonshme profesionale, mund të vendosë edhe për ndarjen e mirënjohjeve të veçanta profesionale, pa cenuar çmimin kryesor “Inxhinieri i Vitit”.

### **Vendimi përfundimtar**

Vendimi i Bordit Drejtues për shpalljen e fituesit është përfundimtar dhe bëhet publik përmes kanaleve zyrtare të komunikimit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës.

Vendimi shoqërohet me një arsyetim të shkurtër profesional, i cili përshkruan kontributin kryesor të fituesit dhe rëndësinë e projektit ose aktivitetit profesional për të cilin është vlerësuar.

## **Neni 10 - Shpallja e çmimit**

Çmimi “**Inxhinieri i Vitit**” shpallet në një ceremoni zyrtare të organizuar nga Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK).

Shpallja e çmimit zakonisht bëhet gjatë aktiviteteve të organizuara me rastin e **Ditës së Inxhinierit**, ose në një aktivitet tjetër të rëndësishëm institucional të organizuar nga OIRK, si konferenca profesionale, takime vjetore ose ngjarje të tjera të rëndësishme të Odës.

Ceremonia e ndarjes së çmimit ka për qëllim të promovojë arritjet profesionale të inxhinierëve dhe të vlerësojë publikisht kontributin e tyre në zhvillimin e profesionit dhe të sektorit të ndërtimit dhe inxhinierisë në Republikën e Kosovës.

Gjatë ceremonisë bëhet prezantimi i shkurtër i projektit ose kontributit profesional për të cilin është vlerësuar fituesi.

### **Vlerësimi dhe publikimi i fituesit**

Fituesi i çmimit “**Inxhinieri i Vitit**” merr:

- certifikatë zyrtare nga Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, si dëshmi e vlerësimit profesional;
- mirënjohje publike për kontributin profesional në fushën e inxhinierisë;

- prezantim të shkurtër të projektit ose kontributit profesional gjatë ceremonisë së ndarjes së çmimit;
- publikim në faqen zyrtare dhe në kanalet zyrtare të komunikimit të OIRK, me qëllim informimin e anëtarëve dhe të publikut për arritjet profesionale të fituesit.

OIRK mund të promovojë fituesin dhe projektin e vlerësuar edhe përmes publikimeve profesionale, mediave, aktiviteteve profesionale ose platformave të tjera të komunikimit institucional.

## **Neni 11 - Transparenca dhe integriteti**

Procesi i përzgjedhjes së fituesit të çmimit “**Inxhinieri i Vitit**” duhet të zhvillohet në mënyrë transparente, profesionale dhe të paanshme, duke u bazuar në kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë udhëzues.

Të gjithë kandidatët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe objektive, pa diskriminim dhe pa ndikime të jashtme që mund të cenojnë integritetin e procesit të vlerësimit.

Bordi Drejtues dhe administrata e OIRK janë përgjegjës për të siguruar që procesi i aplikimit, vlerësimit dhe vendimmarrjes të zhvillohet në përputhje me parimet e etikës profesionale, transparencës dhe përgjegjësisë institucionale.

### **Konflikti i interesit**

Në rast se një anëtar i Bordit Drejtues ka konflikt interesi me një kandidat, ai duhet të deklarojë këtë konflikt dhe të përjashtohet nga procesi i vlerësimit për atë kandidat.

Konflikti i interesit mund të përfshijë, por nuk kufizohet vetëm në rastet kur ekziston:

- bashkëpunim profesional i drejtpërdrejtë në projektin e paraqitur;
- marrëdhënie kontraktuale ose punësimi ndërmjet anëtarit të Bordit dhe kandidatit;
- përfshirje e përbashkët në kompani, projekte ose aktivitete profesionale;
- marrëdhënie të tjera që mund të ndikojnë në paanshmërinë e vlerësimit.

Në raste të tilla, anëtari i Bordit nuk merr pjesë në shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidatit përkatës dhe kjo shënohet në procesverbalin e mbledhjes së Bordit Drejtues.

### **Ruajtja e integritetit të procesit**

Të gjitha informacionet dhe dokumentet e paraqitura nga kandidatët trajtohen me konfidencialitet dhe përgjegjësi profesionale gjatë procesit të vlerësimit.

Bordi Drejtues dhe administrata e OIRK duhet të sigurojnë që vendimet të bazohen vetëm në meritat profesionale të kandidatëve dhe në kriteret e përcaktuara në këtë udhëzues.

Respektimi i këtyre parimeve është thelbësor për ruajtjen e besueshmërisë, reputacionit dhe integritetit të çmimit “Inxhinieri i Vitit” dhe të vetë Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës.

## **Neni 12 - Dispozitat përfundimtare**

Ky udhëzues hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi Drejtues i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK).

Ky dokument përcakton parimet, kriteret dhe procedurat për organizimin dhe realizimin e procesit të përzgjedhjes së fituesit të çmimit “Inxhinieri i Vitit”, dhe shërben si bazë rregullative për zhvillimin e këtij procesi në mënyrë të rregullt dhe transparente.

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e këtij udhëzuesi, organizimin e procesit të aplikimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve, si dhe për organizimin e ceremonisë së ndarjes së çmimit.

Ky udhëzues shërben si bazë për organizimin e përvitshëm të ndarjes së çmimit “Inxhinieri i Vitit”, duke siguruar vazhdimësinë dhe standardizimin e procesit të vlerësimit të kontributit profesional të inxhinierëve.

Çdo ndryshim ose plotësim i këtij udhëzuesi mund të bëhet me vendim të Bordit Drejtues të OIRK, në përputhje me nevojat institucionale dhe zhvillimin e mëtejshëm të profesionit të inxhinierisë.

Interpretimi i dispozitave të këtij udhëzuesi bëhet nga Bordi Drejtues i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës.

Prishtinë, 10 mars 2026

Bordi Drejtues i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës



**ODA E INXHINIERËVE  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

## **FORMULAR APLIKIMI**

### **ÇMIMI “INXHINIERI I VITIT”**

Ky formular plotësohet në përputhje me Udhëzuesin për ndarjen e çmimit “Inxhinieri i Vitit” të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK).

#### **1. Të dhënat e aplikuesit**

Emri dhe mbiemri:

---

Numri i anëtarësisë në OIRK:

---

Numri i licencës OIRK:

---

Fusha e inxhinierisë:

- Inxhinieri ndërtimore (konstruktive)
- Inxhinieri infrastrukurore (rrugë, ura, transport)
- Inxhinieri hidroteknike (ujësjellës, kanalizim, hidroenergjë)
- Inxhinieri energjetike
- Inxhinieri elektrike
- Inxhinieri mekanike / makinerike
- Inxhinieri gjeodezike
- Inxhinieri gjeologjike / gjeoteknike
- Inxhinieri e mjedisit
- Fushë tjetër e inxhinierisë: \_\_\_\_\_

Kompania / institucioni:

---

Pozita profesionale:

---

Vitet e përvojës profesionale:

---

Adresa profesionale:

---

Email:

---

Numri i telefonit:

---

## **2. Informacioni bazë i projektit / Aktiviteti profesional**

Titulli i projektit / aktivitetit profesional:

---

Vendndodhja e projektit:

---

Investitori / autoriteti kontraktues:

---

Periudha e realizimit të projektit:

---

Vlera e projektit (nëse aplikohet):

---

Tipi i projektit / aktivitetit:

- Ndërtesë
- Infrastrukturë rrugore / transporti
- Infrastrukturë energjetike
- Infrastrukturë hidroteknike
- Infrastrukturë industriale
- Projekt mekanik / makinerik
- Projekt elektrik / energjetik
- Projekt mjedisor
- Studim teknik / projektim / analizë profesionale
- Tjetër: \_\_\_\_\_

Roli i kandidatit në projekt:

- Projektues
- Bashkëprojektues
- Mbikëqyrës profesional
- Menaxher teknik i projektit
- Ekspert teknik / specialist
- Konsulent teknik
- Rol tjetër: \_\_\_\_\_

### **3. Kontributi individual i kandidatit**

Përshkruani rolin dhe kontributin tuaj profesional në projekt ose aktivitet:

---

---

---

---

---

### **4. Standardet dhe normat teknike të përdorura**

Shënoni standardet dhe rregulloret teknike të përdorura në projekt:

(p.sh. Eurocode, EN, ISO, IEC, standarde kombëtare etj.)

---

---

---

## 5. Përshkrimi teknik i projektit

Përshkruani karakteristikat kryesore teknike të projektit:

---

---

---

---

## 6. Inovacioni teknik dhe zgjidhjet inxhinierike

Përshkruani zgjidhjet inovative ose kreative të përdorura në projekt:

(p.sh. sisteme strukturore të avancuara, zgjidhje energjetike, teknologji të reja ndërtimi, optimizim teknik, etj.)

---

---

---

---

## 7. Kompleksiteti dhe sfidat teknike

Përshkruani sfidat teknike të projektit dhe mënyrën si janë zgjidhur:

---

---

---

---

## 8. Qëndrueshmëria dhe ndikimi në mjedis

Elementet e qëndrueshmërisë së projektit:

- përdorimi i materialeve të qëndrueshme
- reduktimi i ndikimit në mjedis
- efikasiteti energjetik
- menaxhimi i ujërave dhe mbetjeve

- përdorimi i teknologjive të pastra
- zgjidhje për zhvillim të qëndrueshëm

Shpjegim shtesë:

---

---

---

## 9. Ndikimi public dhe përfitimet shoqërore

Përshkruani ndikimin e projektit në zhvillimin e:

- infrastrukturës
- ekonomisë
- komunitetit
- sektorëve strategjikë

---

---

---

---

## 10. Dokumentet mbështetëse

Ju lutemi bashkëngjitni dokumentet e mëposhtme:

- CV profesionale
- fotografi të projektit
- vizatime ose dokumentacion teknik
- dokumente që dëshmojnë rolin profesional në projekt
- leje ndërtimi / kontratë / raport teknik
- publikime profesionale (nëse ka)
- referenca profesionale
- dokumente të tjera mbështetëse

## 11. Deklarata e aplikuesit

Deklaroj se të gjitha informacionet e paraqitura në këtë formular dhe në dokumentacionin shoqëruar janë të sakta, të plota dhe të vërteta.

Gjithashtu deklaroj se projekti ose aktiviteti profesional i paraqitur përfaqëson kontributin tim profesional dhe se dokumentacioni i bashkëngjitur dëshmon në mënyrë të saktë rolin tim në realizimin e tij.

Jam i vetëdijshëm se paraqitja e informacioneve të pasakta, të rreme ose mashtruese mund të rezultojë në refuzimin e aplikimit dhe mund të paraqesë shkelje të **Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës**, duke sjellë përgjegjësi disiplinore në përputhje me rregullat dhe procedurat e Odës.

Gjithashtu pranoj që Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës të verifikojë dokumentacionin e paraqitur në përputhje me Udhëzuesin për ndarjen e çmimit “Inxhinieri i Vitit”.

Data: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i aplikuesit: \_\_\_\_\_

## 12. Për përdorim Zyrtar nga OIRK

Data e pranimit të aplikimit: \_\_\_\_\_

Dokumentacioni i plotë:

PO

JO

Komente administrative:

---



**ODA E INXHINIERËVE  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

## **MATRICA E VLERËSIMIT**

### **ÇMIMI “INXHINIERI I VITIT”**

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK)

Kjo matricë përdoret nga Bordi Drejtues i OIRK për vlerësimin objektiv dhe transparent të kandidatëve për çmimin “**Inxhinieri i Vitit**”, në përputhje me kriteret e përcaktuara në udhëzues.

Çdo anëtar i Bordit vlerëson kandidatin në mënyrë të pavarur sipas kriterëve të mëposhtme.

<b>Nr.</b>	<b>Kriteri i vlerësimit</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Pikët maksimale</b>
1	<b>Inovacioni teknik dhe kreativiteti inxhinierik</b>	Vlerësohet niveli i inovacionit dhe kreativitetit në zgjidhjet teknike, përdorimi i metodave moderne dhe zgjidhjet kreative inxhinierike në projekt.	20
2	<b>Kompleksiteti teknik i projektit</b>	Vlerësohet niveli i kompleksitetit të projektit, sfidat teknike të përballuara dhe niveli i ekspertizës së kërkuar për realizimin e tij.	20
3	<b>Ndikimi në zhvillimin e shoqërisë dhe infrastrukturës</b>	Vlerësohet rëndësia e projektit për zhvillimin ekonomik, infrastrukturor dhe social të komunitetit ose vendit.	20
4	<b>Qëndrueshmëria dhe mbrojtja e mjedisit</b>	Vlerësohet integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm, efikasiteti energjetik dhe ndikimi në mjedis.	15
5	<b>Cilësia profesionale dhe respektimi i standardeve</b>	Vlerësohet cilësia e projektimit, respektimi i standardeve teknike dhe profesionalizmi në realizimin e projektit.	15
6	<b>Kontributi individual i kandidatit</b>	Vlerësohet roli konkret i kandidatit në projekt dhe ndikimi i tij në zgjidhjet teknike dhe realizimin e projektit.	10
		<b>Pikët totale</b>	<b>100</b>

## REZULTATI I VLERËSIMIT

Kriteri	Pikët
Inovacioni teknik	
Kompleksiteti teknik	
Ndikimi publik	
Ndikimi publik	
Cilësia profesionale	
Kontributi individual	

TOTALI I PIKËVE: \_\_\_\_\_

## UDHËZIME PËR VLERËSIM

- Çdo anëtar i Bordit vlerëson kandidatët në mënyrë të pavarur.
- Pikët për secilin kriter nuk mund të tejkalojnë maksimumin e përcaktuar.
- Kandidati me numrin më të madh të pikëve propozohet për çmimin “**Inxhinieri i Vitit**”.
- Në rast të pikëve të barabarta, Bordi mund të marrë në konsideratë:
  - ndikimin publik të projektit;
  - nivelin e inovacionit teknik;
  - kompleksitetin e zgjidhjeve inxhinierike.

Data: \_\_\_\_\_

Emri i Anëtarit të Bordit: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_